



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Politikën e Jashtme

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 04.02.2014, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Arta Dade – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës për statusin e anëtarëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe të forcës së sigurisë së Republikës së Kosovës gjatë qëndrimit të tyre në territorin e shteteve përkatëse”

2. Seancë dëgjimore me kandidatët për ambasadorë në Maqedoni, Kosovë dhe pranë Selisë së Shenjtë në Vatikan, përkatësisht zotërinjtë Petrit Bushati, Qemal Minxhozi dhe Ardian Ndreca.

Marrin pjesë:

Arta Dade, Aldo Bumçi, Eduard Selami, Gert Bogdani, Namik Dokle, Gramoz Ruci, Olta Xhaçka, Valentina Leskaj, Ben Blushi, Përparim Spahiu, Kastriot Islami.

Mungojnë:

Jozefina Topalli, Vangjel Dule, Shpëtim Idrizi, Fatmir Mediu.

Të ftuar:

Qirjako Qirko - sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme.

Brunilda Koço - specialiste në Drejtorinë e Çështjeve Juridike dhe të së Drejtës Ndërkombëtare.

Kristo Binjaku - përfaqësues nga Drejtoria Juridike në Ministrinë e Mbrojtjes.

Kandidatët për ambasadorë: Petrit Bushati, Qemal Minxhozi, Ardian Ndreca.

HAPET MBLEDHJA

Arta Dade – Të nderuar kolegë, nisim mbledhjen e Komisionit.

Pikë të parë të rendit të ditës kemi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës për statusin e anëtarëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe Forcës së Sigurisë së Republikës së Kosovës gjatë qëndrimit të tyre në territorin e shteteve përkatëse”.

Për të folur për këtë akt kemi të ftuar specialistë nga Ministria e Jashtme dhe nga Ministria e Mbrojtjes.

Kristo Binjaku - Me dëshirë për forcimin e bashkëpunimit ushtarak dypalësh dhe në vijim të zhvillimit të aktiviteteve të përbashkëta, Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë dhe Forca e Sigurisë së Republikës së Kosovës kanë nënshkruar këtë marrëveshje në Prizren, Kosovë, më i korrik 2013. Marrëveshja rregullon procedurat e hyrjes, daljes, qëndrimit të përkohshëm dhe statusin e anëtarëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës në territorin e shteteve përkatëse. Hyrja e forcave ushtarake bëhet vetëm në rastet e stërvitjeve të përbashkëta, trajnimit, kalimit transit dhe në rastet e operacioneve të dhënies së ndihmës humanitare, apo operacionet e kërkim-shpëtimit. Marrëveshja rregullon çështjen e juridiksionit, në rastet kur kemi aksidente e incidente me pasojë dëmtimin fizik të personit, ose dëme materiale. Marrëveshja përcakton se anëtarët e forcës së shtetit dërgues gjatë hyrjes në territorin e shtetit pritës duhet të jenë të pajisur me pasaporta, ose karta identiteti ushtarak, si dhe të jenë të shoqëruar me urdhrin e lëvizjes kolektive. Shoqëruesit e tyre civilë duhet të jenë të pajisur me pasaporta ose karta identiteti. Në nenin 5 sqarohen informacionet që do të shkëmbejnë shtetet mes njëri-tjetrit, për numrin, tipin dhe çdo informacion të nevojshëm

për armët luftarake që anëtarët e forcave respektive do të kenë me vete gjatë qëndrimit të përkohshëm në vendin pritës. Personeli i forcës së shtetit dërgues mund të mbajë armë në zbatim të urdhrave të lëshuar nga autoritetet përkatëse dërguese. Autoritetet e shtetit dërgues do t'i shqyrtojnë me dashamirësi kërkesat e shtetit pritës për sa i përket çështjes së armatimit. Në rast se një shtet gjykon se siguria publike dhe rendi i tij kushtetues kërcënohen nga na e një anëtar i forcës së shtetit tjetër, shteti pritës mund të kërkojë që...

Arta Dade – Më falni, që po ju ndërpres, por ne e lexojmë, sepse relacioni është në dispozicionin tonë! Keni ndonjë gjë specifike, që ne duhet ta...

Kristo Binjaku – S'kemi ç'të themi më tepër sesa është në relacion. Marrëveshja lehtëson procedurat midis hyrje-daljeve në pikat e kalimit të kufirit, lehtëson rastet e zgjidhjes së marrëveshjeve e mosmarrëveshjeve në territorin e një shteti, lehtëson procedurat doganore dhe zgjidh çështjen e juridiksionit në rastin e kryerjes së një krimi. Kjo është bazuar në marrëveshjen NATO – SOFA, të cilën aktualisht Republika e Shqipërisë e ka vetëm me SHBA-në dhe është në proces negocimi me Gjermaninë.

Arta Dade – Ju të Ministrisë së Jashtme, keni ndonjë gjë për të shtuar?

Brunilda Koço – Drejtorja e NATO-s, që ndodhet në Ministrinë e Jashtme, është shprehur pozitivisht për këtë marrëveshje, sepse forcon bashkëpunimin ushtarak dypalësh. Ministria jonë dhe Republika e Shqipërisë mbështesin çdo marrëveshje të Kosovës në fushën ushtarake që do të sjellë afrimin dhe pjesëmarrjen e saj në kuadrin e TFT Member, që është Partnership **Fortis**, të cilat Drejtorja e NATO-s dhe vetë misioni i ynë në Bruksel janë duke lobuar fort që edhe Kosova të bëhet pjesë kësaj iniciative. Kosoava, nga ana e vet ka nënshkruar marrëveshje në fushën ushtarake me vendet anëtare të cilat asistojnë Forcën e Sigurisë në Kosovë, jo në kuadrin e KFOR-it, por të bashkëpunimit dypalësh. Shembull konkret i bashkëpunimit është edhe SOFA e nënshkruar midis SHBA-së dhe Kosovës në vitin 2012. Ambasada amerikane në Prishtinë është shprehur: “Kjo marrëveshje dypalëshe në fushën ushtarake mbështet bashkëpunimin për promovimin e sigurisë së popullit të Kosovës dhe kontribuon në stabilitetin dhe paqen në Ballkan”. Shqipëria mbështet njohjet e Kosovës, sepse normalisht kjo do të ndikojë edhe në pjesëmarrjet e Kosovës në iniciativat rajonale ushtarake.

Kjo marrëveshje sillet për miratim në zbatim të nenit 120 të Kushtetutës. Është parashikuar qartë çdo dispozitë. Respekton legjislacionin e brendshëm të shteteve palë. Do të hyjë në fuqi me procedurën e zakonshme që janë marrëveshjet për hyrjen në fuqi me

shkëmbimin e notave të ratifikimit që bëhet nëpërmjet kanaleve diplomatike. Kjo është ajo çfarë japim ne për Kosovën. Normalisht, është një marrëdhënie e ndërsjellë, por duhet parë në këtë aspekt.

Arta Dade – Faleminderit! Ka pyetje? S’ka.

Dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Të ftuarit janë të lirë.

MBYLLET MBLEDHJA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Politikën e Jashtme

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 04.02.2014, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Arta Dade – kryetare e Komisionit

Seancë dëgjimore me kandidatët për ambasadorë në Maqedoni, në Kosovë dhe pranë Selisë së Shenjtë në Vatikan, përkatësisht zotërinjtë: Petrit Bushati, Qemal Minxhozi dhe Ardian Ndreca.

Marrin pjesë:

Arta Dade, Aldo Bumçi, Eduard Selami, Gert Bogdani, Namik Dokle, Gramoz Ruci, Olta Xhaçka, Valentina Leskaj, Ben Blushi, Përparim Spahiu, Kastriot Islami.

Mungojnë:

Jozefina Topalli, Vangjel Dule, Shpëtim Idrizi, Fatmir Mediu.

Të ftuar:

Qirjako Qirko - sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme.

Brunilda Koço - specialiste në Drejtorinë e Çështjeve Juridike dhe të së Drejtës Ndërkombëtare.

Kristo Binjaku - përfaqësues nga Drejtoria Juridike në Ministrinë e Mbrojtjes.

Kandidatët për ambasadorë: Petrit Bushati, Qemal Minxhozi, Ardian Ndreca.

Kolegë të nderuar, vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës, seancë dëgjimore me kandidatët për ambasadorë në Maqedoni, në Kosovë dhe pranë Selisë së Shenjtë në Vatikan, përkatësisht zotërinjtë: Petrit Bushati, Qemal Minxhozi dhe Ardian Ndreca.

Për të prezantuar kandidaturat kemi të pranishëm sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme, zotin Qiriako Qirko.

Fjalën e ka zoti Qirko.

Qiriako Qirko – E nderuar zonja kryetare,

Të nderuar anëtarë të Komisionit të Jashtëm,

Ministria e Jashtme ka sot nderin të prezantojë përpara këtij komisioni të nderuar tri kandidatura për postin e ambasadorit në Kosovë, në Vatikan dhe në Maqedoni. Të tria kandidaturat janë intelektualë të spikatur dhe me karrierë të pasur në fusha të ndryshme. Zoti Minxhozi, që ju e njihni më mirë se ne, sepse për një kohë të gjatë ka pasur kontribut të veçantë edhe brenda këtij komisioni të nderuar, është propozuar për ambasador në Kosovë. Ka mbaruar fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë, dega e gjuhës angleze dhe ka shërbyer si deputet i Kuvendit të Shqipërisë gjatë viteve 2005-2009 dhe 2009-2013. Në vitet 2002-2005 ka qenë i ngarkuar me punë pranë Mbretërisë së Danimarkës dhe më duhet ta theksoj se periudha gjatë së cilës zoti Minxhozi ka shërbyer si përfaqësues ynë në Danimarkë ka qenë një ndër periudhat me më aktivitet si në planin politik, ashtu edhe në atë ekonomik. Pra, veçohet aktiviteti i zotit Minxhozi si përfaqësues ynë në Danimarkë.

Kandidatura e dytë për ambasador është e zotit Ardian Ndreca.

Zoti Ndreca është kandidaturë e spikatur. Vjen nga fusha akademike, me një karrierë mjaft të pasur në fushën akademike. Është profesor i Filozofisë pranë Universitetit Urbaniana prej 15 vjetësh, dhe pranë Xhon Karrol University të Klivelandit, është kryeredaktor që nga viti 2006 i “Hyllit të dritës”, ka një aktivitet mjaft të pasur në fushën filozofike dhe është autor i disa librave dhe autor i dhjetëra shkrimeve në këtë fushë.

Kandidatura e tretë është kandidatura e zotit Petrit Bushati, i cili propozohet për ambasador në Maqedoni.

Zoti Bushati është një diplomat karriere me një karrierë shumë të pasur. Karriera e tij fillon përpara 30 vjetësh në shërbimin e jashtëm. Ka shërbyer në poste drejtuese në këtë ministri, sikurse ka qenë për disa vjet drejtor i Drejtorisë së Amerikave. Më tej ka qenë ambasadori ynë në SHBA, në Serbi, në Mal të Zi e kështu me radhë.

Besoj se të tria kandidaturat, nëse ky komision do të japë pëlqimin e tij, i bëjnë një shërbim të mirë prezantimit të vendit tonë në arenën ndërkombëtare, veçanërisht në vendet fqinje dhe në marrëdhëniet specifike me Vatikanin.

Faleminderit!

Arta Dade – Faleminderit!

Kam kënaqësinë e veçantë që t'ia jap fjalën zotit Minxhozi, kolegut tonë në komision prej 2 legjislaturash, një nga personalitetet e spikatura, ashtu siç u tha këtu, madje marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Danimarkës janë nxitur në nivele të pëlqyeshme dhe shumë të mira edhe kur zoti Minxhozi nuk ka qenë ambasador, por i ngarkuar me punë, duke i shërbyer vendit duke i shërbyer nashkëpunimit në të gjitha fushat: në fushën e drejtësisë, në fushën e konsolidimit të pushtetit vendor. Zoti Minxhozi, keni fjalën.

Qemal Minxhozi – Të nderuar deputetë të Komisionit të Jashtëm, në fillim të fjalës sime nuk mund të rri pa nënvizuar një specifikë, e cila më lidh pazgjidhshmërisht me këtë ambient dhe me shumë prej jush personalisht.

Shumica prej nesh kanë qenë kolegë në këtë forum të nderuar dhe të lartë të parlamentit shqiptar. Dëshiroj të falënderoj fillimisht secilin prej jush, me të cilin kam pasur kënaqësinë dhe nderin të bashkëpunoj për tetë vjet në fushën e politikës së jashtme dhe diplomacisë. Për mua është një nder dhe vlerësim i veçantë që paraqitem përpara këtij komisioni për të kërkuar prej jush miratimin për emërimin tim në pozicionin e lartë të ambasadorit të Republikës së Shqipërisë në Republikën e Kosovës. Këtë ngjarje unë nuk e konsideroj një nominim të thjeshtë diplomatik, por më gjerë, sepse ndihem i privilegjuar për propozimin që qeveria ju ka bërë juve dhe Presidentit për këtë post të lartë. Me përvojën time si deputet i parlamentit dhe si njohës i politikës së jashtme të Shqipërisë do të bëj çfarë është e mundur për të realizuar interesat strategjike, politike dhe kombëtare të shtetit shqiptar në Republikën e Kosovës.

Si çdo ambasador do të përpiqem të zbatoj një linjë politike, diplomatike që ka në themel interesat e shtetit dhe të kombit shqiptar. Jam i ndërgjegjshëm se detyra që më ngarkohet është e lehtë dhe e vështirë njëkohësisht. Është një vend që flitet dhe mendohet shqip. Të jesh ambasador i Shqipërisë në Kosovë është privilegj, avantazh dhe kënaqësi, por është edhe një detyrim dhe një përgjegjësi shumë e madhe. Veçoria midis dy shteteve shqiptare të dikton që veprimtaria ime si ambasador të jetë shumëplanëshe dhe të përputhet me interesat e shtetit dhe të

kombit. Prania e dy shteteve, të Shqipërisë dhe të Kosovës përbën një kapacitet qeverisës dhe administrativ shumë të madh për të ndërtuar një të ardhme të përbashkët euroatlantike.

Besoj se biem të gjithë dakord se synimi kryesor në marrëdhëniet e sotme midis Shqipërisë dhe Kosovës është formatimi dhe institucionalizimi i tyre. Në këtë rrafsh prioritet madhor do të jetë bashkëpunimi strategjik midis dy shteteve dhe zbatimi i plotë dhe i frytshëm i marrëveshjeve tashmë të nënshkruara. Ashtu siç është pranuar nga qeveritë e dy vendeve tona, bashkëpunimi strategjik me Kosovën do të jetë në funksion të rritjes ekonomike, në përmirësimin e cilësisë së jetës së shqiptarëve në të dy shtetet, si edhe në përshpejtimin e procesit të integritetit euroatlantik të dy vendeve. Një rol të veçantë midis dy vendeve do të marrë edhe bashkëpunimi parlamentar. Nisur edhe nga mbledhja e parë e përbashkët midis dy qeverive në Prizren, në muajin e kaluar dalin në pah fusha me interes të përbashkët, që prodhojnë vlera të rëndësishme monetare, social-ekonomike, prandaj puna duhet të përqendrohet ndërmjet të tjerave për të konceptuar zhvillimin ...si një instrument për sigurimin..... e të hapësirës shqiptare, për një sistem të unifikuarnga shkolla fillore deri në universitet, për një strategji mbarëkombëtare për bujqësinë, për më shumë liri dhe konkurrencë për biznesin shqiptar në të gjithë hapësirën shqiptare, për të njëzuar ofertën turistike të hapësirës shqiptare edhe në sektorët që ofrojnë mundësi të dyanshme zhvillimi, si për shembull në art, kulturë e kështu me radhë. Shteti shqiptar ka për detyrë të ofrojë të gjitha kapacitetet, resurset e tij, në mënyrë që njohja e Kosovës të vijojë e pandërprerë konform edhe angazhimeve konkrete të ndërmarra nga të dyja qeveritë tona.

Sot Kosova është një realitet i ri dhe dinamik, ndaj edhe përkushtimi im do të ishte maksimal nëse unë do të merrja besimin tuaj për të qenë ambasador i Republikës së Shqipërisë në Kosovë.

Arta Dade - Faleminderit, zoti Minxhozi!

Në CV-në tuaj ndikon edhe puna si anëtar i Sekretariatit të Marrëdhënieve Ndërparlamentare të Parlamentit. Ju keni harruar ta përfshini këtë detyrë të rëndësishme.

Të nderuar kolegë, më lejoni t'i jap fjalën zotit Petrit Bushati, një nga personalitetet e diplomacisë shqiptare, i cili me modestinë që e ka karakterizuar, përveç kapaciteteve si diplomat, i ka kryer detyrat në dobi të interesave të vendit dhe të kombit.

Zoti Bushati, keni fjalën.

Petrit Bushati - Ju faleminderit!

E nderuara zonja kryetare e komisionit,

Zonja dhe zotërinj deputetë, anëtarë të komisionit, jam i privilegjuar që më jepet mundësia të paraqes përpara këtij komisioni të nderuar disa nga objektivat dhe përparësitë kryesore të punës sime dhe të personelit diplomatik që do të drejtojë marrëdhëniet dypalëshe midis Shqipërisë dhe Maqedonisë. Do të ishte e panevojshme të theksoja përpara këtij komisioni të respektuar profesionistësh dhe me përvojë të gjatë në politikën e jashtme, të informuar gjerësisht për ponderancën që ka në politikën e jashtme të Shqipërisë marrëdhëniet me vendet fqinje dhe në mënyrë të veçantë me Republikën e Maqedonisë. Është fakt i shënuar se që prej themelimit të Republikës së Maqedonisë, njohjes ndërkombëtare dhe anëtarësimit të saj në OKB, Republika e Shqipërisë ka ndjekur në mënyrë konstante një politikë konstruktive, të balancuar dhe të fqinjësisë së mirë, pavarësisht nga problemet që kanë ekzistuar, mbase ndonjëherë ekzistojnë edhe sot në një hark kohor prej 22 vjetësh. Republika e Shqipërisë ishte një nga vendet e para në rajon dhe në botë që ka bërë njohjen zyrtare të Republikës së Maqedonisë nëpërmjet një deklarate zyrtare. Duke lënë modestinë për një çast mënjane, ndjem krenar si një nga bashkëhartuesit e kësaj deklarate në atë kohë.

Zonja dhe zotërinj deputetë, duke u përpjekur të respektoj kohën tuaj të çmuar, më poshtë po përpiqem të paraqes një ekspozë të objektivave dhe problemeve në marrëdhëniet me fqinjën tonë Maqedoninë.

Në përputhje të plotë me programin e qeverisë, me vazhdimësinë e arritjeve dhe të sukseseve gjatë dy dhjetëvjeçarëve, forcimi i mëtejshëm i marrëdhënieve dypalëshe me Maqedoninë në të gjitha fushat me interes reciprok është një prioritet i pashmangshëm, i cili lidhet ngushtë me veprimin aktiv të përditshëm në mbajtjen e kontakteve të vazhdueshme dhe në përkujdesjen për bashkëpunimin e paanshëm, intensiv dhe të gjithanshëm me faktorin shqiptar.

Deri sot janë realizuar një sërë objektivash kryesorë dhe është arritur të përmbushen me sukses në pjesën më të madhe detyrat funksionale. Niveli i shkëmbimeve të larta politike, shkëmbimi i vizitave dhe i takimeve të nivelit të lartë kanë shënuar një moment pozitiv në rritje.

Dëshiroj të nënvizoj se pas formimit të qeverisë së re, të drejtuar nga Kryeministri Edi Rama dhe vizitës së tij në muajin nëntor të vitit të kaluar, ka pasur një intensifikim të dukshëm të vizitave dhe një qasje të re të politikës së vendit tonë në marrëdhëniet me Maqedoninë. Kjo qasje e re, pa mohuar për asnjë çast arritjet në të shkuarën, nuk ka të bëjë me ndryshime esenciale apo me zgjidhje finale të çdo problemi në këto marrëdhënie, por më shumë me një koncept të qartë

dhe konkret, se në çfarë drejtimi duhet të fokusohet vëmendja dhe cilat do të jenë objektivat e afërta dhe të largëta për t'u realizuar në këto marrëdhënie dypalëshe.

Po përmend disa nga çështjet prioritare në planin afatshkurtër dhe atë afatmesëm. Duke u nisur nga sa më sipër dhe në përputhje me analizën e Ministrisë së Jashtme, mendoj se disa nga çështjet prioritare mund të jenë në planin e marrëdhënieve politike. Vëmendja jonë duhet të fokusohet te zhvillimi i marrëdhënieve të mira fqinjësore, të nxitjes së mëtejshme të frymës së mirëkuptimit dhe të bashkëpunimit në të gjitha fushat. Në fushën e të drejtave të shqiptarëve në Maqedoni, marrëveshja e Ohrit do të jetë vazhdimisht pikë referimi në të gjithë procesin e brendshëm politik. Kjo marrëveshje duhet të miratohet pa zvarritje të mëtejshme.

Në planin e marrëdhënieve ndërmjet shqiptarëve në Maqedoni, do të synohet të nxitet bashkëpunimi me një frymë pozitive dhe konstruktive ndërmjet partive politike shqiptare, pa ndërhyrë në identitetin dhe në pozicionet e tyre. Në këtë pikë të rëndësishme do të thosha se roli i përfaqësisë sonë në Shkup, duhet të jetë aktiv, por i balancuar dhe i paanshëm, duke shmangur çfarëdolloj qëndrimi apo sjelljeje në konotacion politik ose shfaqje të shenjave të paternalizmit. Çdo tejkalim i rolit dhe funksioneve diplomatike të përshkruara qartë në platformën e Ministrisë së Jashtme për politikën e jashtme në marrëdhënie me fqinjët do të dëmtonte interesat e vetë faktorit shqiptar shtetformues në Maqedoni dhe do të ndikonte në krijimin e keqkuptimeve në frymën e përgjithshme të marrëdhënieve shtetërore dypalëshe.

Ambasada jonë në Shkup, si në planin e marrëdhënieve shtetërore, por dhe në aspektin e marrëdhënieve me partitë politike, do të respektojë në veçanti programet e ndryshimet që kanë në pikëpamje. Pra, marrëdhëniet me to do të jenë të ndërtuara krejtësisht mbi bazën e respektit demokratik, të pluralizmit partiak, të respektit dhe të konsideratës së interesave të tyre në aktivitetin e tyre politik.

Një pikë tjetër është edhe koordinimi i punës dhe nxitja më tepër e angazhimit të palës maqedonase për ndërtimin e Korridorit 8, përfshirë edhe linjën hekurudhore ndërmjet dy vendeve.

Gjithashtu është e nevojshme të nxiten procedurat për të arritur një marrëveshje për ekonominë e ujërave. Kjo marrëveshje është propozuar nga pala shqiptare në vitin 2004, me tekst të organeve paraqitur palës maqedonase, në mënyrë që ajo të nënshkruhet sa më shpejt duke bërë përpjekje që të shmanget çdo vonesë ose ngadalësi qoftë edhe nga faktorë të tjerë në nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje. Pala jonë duhet të insistojë fort që ajo të nënshkruhet, pasi rregullimi i

regjimit të ujërave me marrëveshjen e kohës së ish-Jugosllavisë nga njëra anë nuk i përgjigjet kohës aktuale dhe nga ana tjetër interesat ekonomike të vendit tonë në këtë fushë janë shumë të mëdha. Ne mund t'u referohemi edhe marrëveshjeve të shkruara para vitit 1992, për të cilat Maqedonia ka detyrim dypalësh si shtet suksesor i ish-Federatës Jugosllave.

Liqeni i Ohrit të shfrytëzohet si hapësirë natyrore dhe preferenciale për bashkëpunimin me turizmin; të vihet linja e transportit ujq gjatë stinës së verës 2014; të bashkërenditet puna për ndërtimin e linjës 400 kilovolt Manastir-Elbasan; të bashkërendohet puna për rinovimin e një marrëveshjeje për arsimin; të punohet për avancimin e marrëveshjeve, me qëllim lehtësimin e mëtejshëm të pengesave dhe eliminimin e barrierave administrative në tregti në lidhje me bashkëpunimin dhe bashkërendimin e aktiviteteve në ambasadën e Kosovës dhe koordinimin me ambasadën në Shkup. Për të gjitha takimet e nivelit të lartë Republika e Shqipërisë ka shprehur dëshirën dhe vendosmërinë e saj për krijimin një hapësire të re dhe marrëdhënie shumë të mira fqinjësore, ka garantuar integritet territorial të Maqedonisë, ka shmangur deklaratimet me ngjyra nacionaliste, por në të njëjtën kohë do të vazhdojë të kërkojë me devotshmëri implementimin e plotë të Marrëveshjes së Ohrit, si dhe rend kyç në politikën e brendshme të vendit plotësimin e të drejtave të shqiptarëve në Maqedoni.

Duke marrë parasysh që me gjithë angazhimin e palës sonë, marrëdhëniet ekonomike ndërmjet Shqipërisë dhe Maqedonisë nuk do të ecin me të njëjtin ritëm sikurse marrëdhëniet politike. Në vëmendje të punës sime dhe të të gjithë personelit do të jetë nxitja dhe ngritja në një nivel të ri të marrëdhënieve ekonomike.

Sipas analizës së Ministrisë së Punëve të Jashtme, konstatohet se ndër shkaqet kryesore të nivelit aktual të marrëdhënieve ekonomike janë:

Së pari, të dyja vendet janë të vogla, me treg të kufizuar. Për vitin 2012 shkëmbimet e dyanshme tregtare, pra Shqipëri-Maqedoni, kapën vlerën 93,3 milionë euro, që është një shifër pak a shumë modeste dhe jo ajo që pëfaqëson të gjitha kapacitetet në të dyja vendet. Maqedonia ose Shqipëria nuk mund të shërbejnë siguri në furnizimin kryesor për njëri-tjetrin për shkak të rolit të tyre në rajon, që janë vende me popullsi dhe territor të kufizuar.

Së dyti, infrastruktura rrugore mes të dyja vendeve është e keqe. Pala maqedonase nuk është ende në nivelin e kërkuar të investimeve në Korridorin 8. Do të dëshironim që edhe ajo të avanconte bashkërisht me planet e infrastrukturës në Shqipëri.

Së treti, vendet e ish-Jugosllavisë ruajnë ende sot lidhje të vjetra dhe tradita tregtare ndërmjet tyre.

Së katërti, vetë bizneset e të dyja vendeve nuk janë fort aktive në zhvillimin dhe nxitjen e këtyre marrëdhënieve.

Duke përmbledhur trajtimet kryesore të bashkëpunimit, në të ardhmen do të fokusohemi në këto fusha: në energjetikë, infrastrukturë rrugore, bujqësi, turizëm, arsim, kulturë, shkencë, por edhe në fusha të tjera me të cilat bashkëpunimi deri tani ka munguar ose është fare minimal, siç është bashkëpunimi me botën universitare, me atë akademike, me pushtetin vendor, me medien dhe shoqërinë civile.

Të nderuar zonja e zotërinj,

Të nderuar anëtarë të komisionit, duke qenë plotësisht i ndërgjegjshëm se detyra që propozohet mbart ngarkesën dhe përgjegjësinë e madhe të përfaqësimit dinjitoz dhe në nivel të lartë profesional të Republikës së Shqipërisë në Republikën e Maqedonisë, dëshiroj të shpreh angazhimin dhe përkushtimin tim të plotë për t'i përballuar me dinjitet dhe me nivel të lartë profesional sfidat e zhvillimit pozitiv dhe të shëndetshëm të marrëdhënieve me fqinjin tonë, Shqipërinë.

Në kuptimin semantik të diplomacisë bashkëkohore, ambasadori dhe diplomatët që ai rrethon në një përfaqësi u shërbejnë në çdo moment interesave sublimë të shtetit të tyre dhe kanë detyrë parësore nxitjen e klimës së bashkëpunimit, mirëkuptimit, sigurisë, paqes dhe prosperitetit ekonomik në një habitat demokratik e transparent siç duhet të shndërrohet rajoni ynë ekonomik.

Kjo më motivon për të qenë gjithnjë në lartësinë e duhur në shërbimin dhe mbrojtjen e vazhdueshme të interesave të Republikës së Shqipërisë.

Dëshiroj ta mbyll paraqitjen time duke falënderuar kryetaren e Komisionit për Politikën e Jashtme, zonjën e nderuar Arta Dade, të gjithë anëtarët shumë të respektuar të komisionit, me shumicën e të cilëve puna ime si diplomat më ka lidhur shpesh, madje kam edhe njohje më të mirë të punës....

Një falënderim shkon edhe për qeverinë që më propozon dhe për ministrin e Jashtëm, zotin Ditmir Bushati, që më ka propozuar në këtë post të rëndësishëm, i cili shpresoj të mbështetet nga ky komision dhe të dekretohet në postin e propozuar.

Ju falënderoj për vëmendjen!

Arta Dade – Ju falënderoj zoti Bushati për prezantimin, i cili edhe një herë tregoi se jeni njohës i thellë i politikës rajonale edhe për shkak të detyrave që keni mbajtur në kuadrin rajonal.

Dëshiroj t'ia jap fjalën tani zotit Ardian Ndreca, i cili ndoshta këtë detyrë e ka të parën, si një nga detyrat diplomatike, por CV-ja e tij është e pasur në përvojën dhe karrierën akademike.

Zoti Ndreca, keni fjalën.

Ardian Ndreca – E nderuara zonja kryetare e Komisionit,

Të nderuar deputetë,

Siç e thatë edhe ju vetë, unë vij nga bota akademike, nuk kam shërbyer asnjëherë për shtetin shqiptar nga bota diplomatike dhe CV-ja ime ka të bëjë vetëm me kërkime shkencore në fushën e historisë dhe të filozofisë moderne. Megjithatë kam 23 vjet që jetoj në shtetin fqinj dhe prej 12 vjetësh punoj në botën akademike.

Marrëdhëniet tona me Vatikanin kanë qenë vazhdimisht të mira pas vendosjes së marrëdhënieve diplomatike në vitin 1991. Vatikani është një shtet me sipërfaqe prej gjysmë kilometri katrorë, por, megjithatë, ka 178 përfaqësi diplomatike të huaja dhe 80 përfaqësi të vetat në shtete të tjera, ku duhet të them se shumica e përfaqësuesve të Vatikanit në shtete të tjera janë dekanë të trupës diplomatike të shteteve të akredituara. Pra, kanë një autoritet të spikatur moral dhe një marrëdhënie e ngrohtë, e sinqertë dhe e gjallë me Vatikanin do të ndihmonte edhe nëpërmjet këtij roli që ai ka.

Ushtria e Vatikanit është diplomacia, duke qenë se është edhe diplomacia më e vjetër sot në botë dhe roli moral është vendimtar në të gjitha marrëdhëniet që ky shtet ka me vende të tjera. Mjafton të them se përfaqësuesit e shteteve të mëdha, si Franca, De Goli menjëherë pas mbarimit të luftës dërgoi në Vatikan një filozof, Zhak Maritenin. Rusia kishte dërguar më përpara, para bashkimit në vitin 18... ndoshta vetë filozofin Aleksandër fon Humboldt. Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të gjithë ambasadorët e fundit amerikanë janë persona shumë të afërt të Presidentit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, përfshirë dhe ambasadorin e fundit. Ne si popull kemi kredite historike pranë Selisë së Shenjtë dhe këto kredite historike janë që nga rrënjët e krishtëritimit në Shqipëri, por vazhdojnë edhe në dy dekadat e fundit, kur kisha katolike dhe shqiptarët kanë pasur në mënyrë të vazhdueshme një qëndrim në favor të lirisë dhe demokracisë dhe janë persekutuar prej regjimit komunist. Mendoj se këto kredite historike duhet të shfrytëzohen në mënyrë racionale në të mirën e vendit tonë. Unë punoj si profesor në një universitet të Vatikanit dhe jam në dijeni të klimës mjaft të gatshme për bashkëpunim, mjaft

miqësore kundrejt vendit tonë. Gjithsesi, jam i bindur se marrëdhëniet e drejta me shtetin e Vatikanit nga ana e shtetit shqiptar mund të bazohen vetëm te laiciteti, kjo vlerë e madhe që ka shteti demokratik shqiptar në gjirin e të cilit jetojnë besime të lira, në një shtet që është i vetmi arbitër kundrejt të gjitha besimeve fetare, i mbron të gjitha me të njëjtin intensitet dhe të njëjtën kthjelltësi.

Duke qenë se dialogu ndëretnik, ndërftar dhe ndërkulturor është një strategji e shtetit shqiptar, e qeverisë shqiptare, besoj se bashkëpunimi bilateral me shtetin e Vatikanit do të pasurohej dhe do të ndërmjetësohej edhe nëpërmjet vetë pranisë së Kishës Katolike shqiptare, në vendin tonë dhe të kishës katolike të arbëreshëve në Itali. Kontributi në këto dekadat e fundit të kishës katolike, është i njohur si në arsim, shëndetësi, si në botën sociale, sepse ka luajtur një rol katalizatori shoqëror në Shqipërinë e viteve demokratike. Mendoj se bashkëpunimi me Vatikanin mund të zhvillohet në disa rrafshë, një prej të cilave është rrafshi kulturor. Ne kemi nevojë për kulturë. Jam i bindur se më tepër se nevojë për bukë, kemi nevojë për kulturë, sepse na mungon kultura, prodhojmë pak kulturë. Megjithëse në të kaluarën ka pasur marrëveshje me Vatikanin për fushën e arkivave, nuk janë finalizuar për arsye se marrëveshjet nuk janë bërë në mënyrën e duhur. Duhet t'ju them se në Vatikan ekziston një arkiv, që quhet arkivi Propaganda Fide me të cilin nuk është bërë asnjëherë një marrëveshje. Ka rreth 85 dosje me nga 2-3 mijë dokumente secila që shkojnë nga viti 1624 deri në ditët e sotme, por janë nën embargo që nga viti 1940. Në këto materiale arkivore gjenden dokumente jashtëzakonisht të rëndësishme për gjuhën, kulturën dhe historinë e popullit tonë.

Si kryeredaktor i revistës “Ylli i Dritës” me anën e bashkëpunëtorëve të mi kam zbuluar disa prej këtyre dokumenteve të cilët kanë ngjallur një interes ndër qarqet e albanologëve në Mynih, *(nuk dëgjohet nga zhurma)*

Besoj se me të njëjtin institucion mund të punohej dhe me specializimin e mëtijshëm të specialistëve tanë në fushën e restaurimit të librave, të veprave kulturore dhe mundësisht edhe në fushën e mirëmbajtjes dhe restaurimit të veprave të objekteve të kultit me një rëndësi të veçantë historike, siç mund të jenë afresket e kishës së Rubikut ose abacia e Shën Shirgjit, që është një ndër dokumentet të gjalla mesjetare të kultit, që pasqyron shpirtin dhe vokacionin perëndimor të kombit tonë.

Në fushën e kulturës, gjithashtu, ne kemi fatin të kemi në Shqipëri një prej kodikëve venecianë që është Purpurius Galutinus, kodi i famshëm, njëri prej tyre gjendet në Shqipëria,

ndërsa disa të tjerë gjenden në Itali, në Gjermani, në Britaninë e Madhe. Do të ishte një rast fatlum në qoftë se në vendin tonë ose në Vatikan të mund të hapej një ekspozitë ku ne t'i tregonim botës se kush jemi, falë edhe tolerancës sonë fetare, që është një prej pasurive më të mëdha që ka populli shqiptar. Një vlerë tjetër e madhe është Nënë Tereza, e cila është një ambasadore, edhe pas vdekjes e gjallë e popullit tonë.

Mendoj se edhe në fushën e shëndetësisë marrëdhëniet mund të aktualizoheshin, jo se nuk ka marrëveshje të nënshkruara, por potencialet janë shumë më të mëdha dhe mund të përdreshin duke filluar prej Spitalit Pediatrik, që është një ndër më të mëdhenjtë në Itali. Ka një marrëveshje me të, por në qoftë se do të jepeshin facilitete edhe nëpërmjet shtetit italian nëpërmjet kompanive ajrore, brenda pak orëve, në qoftë se një fëmijë shqiptar ndodhet në gjendje të rëndë, mund t'i krijoreshin të gjitha kushtet që t'i jepej ndihma e veçantë, kjo do të ishte një gjë mjaft e mirë dhe humanitare për ne.

E njëjta mundësi zhvillimi ekziston dhe me spitalin “Zoja e Këshillit të Mirë” dhe në të gjithë institucionin akademik. Financimet nuk janë gjetur deri në këtë moment, por jam i bindur se në qoftë se do të punohet edhe me frymën e re që është krijuar në Vatikan mbas ndërrimeve të vitit të kaluar, besoj se shuma prej 15 milionë eurosh, që nuk është e jashtëzakonshme, do të mund të gjendej për të përfunduar këtë vepër të madhe.

Edhe në fushën e turizmit është firmosur një marrëveshje në prillin e vitit 2011, por nuk është bërë asnjëherë operative. Vatikani ka një prej agjencive turistike më të fuqishme në Europë, që organizon udhëtime në të gjithë botën. Ne, teorikisht, jemi në këtë itinerar, por realisht nuk ka një fluks turistësh. Në qoftë se do të krijoreshin kushtet minimale që dhe Izraeli, Palestina, Jordania, ia krijon Vatikanit, për të sjellë turistë, për ta bërë të njohur Shqipërinë nga ana kulturore turizmin tonë, pasuritë që kemi, mendoj se do të ishte një stimul edhe për ekonominë vendase. Gjithashtu, jam i bindur se po të ushqehet me anë të politikës sonë të jashtme, në qoftë se ushtria e mirëfilltë shqiptare do të ishte diplomacia, ne do të mund të afronim edhe organizata dhe fushata të tjera të cilat bashkëpunojnë me Vatikanin, siç është Sant Egidio roli i së cilës u pa më 1999-n kur ndërhyri pranë autoriteteve të Beogradit për lirimin e Presidentit të mëvonshëm të Kosovës, zotit Rugova.

Edhe sot jam i bindur se shoqata do të jepte një kontribut të rëndësishëm në stabilizimin e rajonit, e në mënyrë të veçantë me situatën në Kosovë dhe marrëdhëniet me fqinjët tanë. Kosova, e cila është *punctum dolens* i politikës së jashtme të të gjithë Ballkanit.

Unë nuk jam këtu për të gjykuar aktivitetin e pararendësve, as aktivitetin e qeverive të tjera. Në kushtet e sotme mendoj se mund të bëhet shumë më tepër për një rishikim të çështjes së njohjes së Kosovës nga ana e Vatikanit.

Vitin e fundit politika e jashtme e Vatikanit ka ndryshuar. Kështu që po të kemi një koordinim të mirë me qeverinë e Kosovës dhe mbi të gjitha një bashkëpunim të singertë, do të arrijmë rezultate mjaft të mira, që do të na çojnë drejt njohjes së shtetit të Kosovës.

Së fundi, besoj se Vatikani, falë rrjetit diplomatik që ka, mund të luajë një rol shumë pozitiv në çështjen e integritetit të vendit tonë për në BE, sepse ne nuk jemi një shtet islamik. Ne jemi një shtet me larmi fetare dhe kemi rrënjë perëndimore dhe vokacion perëndimor. Kultura jonë është kulturë e humanizmit europian. Jemi i vetmi shtet në Ballkan që ka një letërsi të shekullit 16-17 në gjuhën latine. Pra, jemi shumë afër rrënjëve të Europës. Besoj se kjo do të ishte edhe pasaporta jonë më e mirë për të kërkuar të drejtat tona për integritetin e vendit tonë.

Në bazë të situatës aktuale mendoj se ekziston mundësia e një vizite të Atit të Shenjtë në Shqipëri. Kjo vizitë në Ballkan do të ishte shenjë e stabilitetit dhe e vullnetit të Shqipërisë.

Ju falënderoj për vëmendjen! Unë jam një person i realizuar dhe i integruar në botën akademike të shtetit fqinj. Kam pranuar dhe vlerësuar ftesën e Kryeministrit Rama që të jap kontributin tim meqenëse e njoh edhe realitetin e Selisë së Shenjtë.

Faleminderit!

Arta Dade – Zoti Ndreca, ju falënderoj! Të jeni i bindur se detyra e ambasadorit nuk është një detyrë e lartë dhe vjen si rezultat i një propozimi dhe angazhimi serioz, me integritet, me kualitetete përkatëse në diplomaci për interesat madhore të vendit.

(Diskutime në sallë.)

Aldo Bumçi - Ne ramë dakord që kur të mbarojë i gjithë prezantimi i pyetjeve, diskutimin e kandidaturave mund ta bëjmë edhe...

Arta Dade – Ne thamë të dëgjonim vetëm prezantimin dhe pastaj të vazhdonim...

Ju e dini shumë mirë që në seancën paraardhëse të komisionit një nga televizionet shumë serioze e deformoi tërësisht mesazhin që ne dhamë këtu. Ose gazetarët nuk janë të vëmendshëm kur ne flasim, ose kanë ndonjë qëllim tjetër.

(Diskutime në sallë.)

Kandidatët e nderuar për ambasadorë do të jenë deri në fund të mbledhjes së komisionit.

Aldo Bumçi – Faleminderit, zonja Kryetare!

Dua t'i falënderoj të tre kandidatët për ambasadorë për prezantimin që bënë. Gjithashtu, dëshiroj të them se ne kemi një çështje parimore, themelore, që nuk ka të bëjë me meritën e kandidaturës, por me propozimet e Ministrisë së Jashtme. Në këtë hark kohor, prej 4 muajsh, Ministria e Jashtme ka propozuar 11 kandidatura për ambasadorë, 6 prej të cilave janë jashtë sistemit të karrierës, ose, siç i quajmë rëndom janë, politike. Nuk mund të ketë reformë kur nuk vendosen rregullat, kohëzgjatja, grada, statusi dhe përvoja. Kur kandidaturat politike mbizotërojnë mbi ato të sistemit, do të thotë se reforma dhe sistemi ka rënë. Kjo është e rëndë për Shqipërinë, sepse ne jemi një vend me një përvojë 23- vjeçare në politikën e jashtme si vend i lirë, një vend i vogël, pa burime.

Në qoftë se ne do të godasim shërbimin e jashtëm, si do të krijohet njohuria apo tradita për të përfaqësuar Shqipërinë? Këtë nuk mund ta bëjnë ministrat e Jashtëm edhe nëse do të kishin kohë të gjatë në detyrën e tyre. Pra, si në çdo vend vazhdimësinë dhe trashëgiminë e krijojnë shërbimi i jashtëm, pra, trupi diplomatik. Pra, nga një mungesë reforme, po kthehet në një antireformë. Reforma ka rënë dhe kjo po kthehet në një qasje antisistem.

Faleminderit!

Arta Dade – Me gjithë respektin që kam për kolegun e nderuar të opozitës, dua t'i them se edhe për procedurë shkeli bazat e caktuara dhe të rëna dakord në mbledhje, lidhur me këtë procedurë, pra, për të bërë dëgjimin e kandidaturave.

E dyta, më lejoni ta përsëris, meqë ju jeni i shqetësuar për karrierën diplomatike, se në 8 vjet qeveria juaj ka bërë masakër në trupën diplomatike. Për sa u përket kandidaturave dhe punës së këtij komisioni, i kemi dëgjuar me vëmendje. Në ndonjë rast edhe ne, përfaqësuesit e maxhorancës, kemi shprehur ndonjë rezervë të caktuar, por nuk është ashtu siç thoni ju, se kandidaturat varen nga politikat. Kandidaturat edhe ato që kanë ardhur në momentin aktual mund të kenë qenë jashtë sistemit, por kanë pika takimi me karrierën e tyre diplomatike. Pra, nuk mund të konsiderohen në asnjë rast emërime politike. Pa dyshim që në ligj është parashikuar që një 20%-sh lejohet të jetë edhe jashtë karrierës diplomatike. Kjo i shërben çdo maxhorance, që për interesat madhore të vendit të gjykojë në lidhje me emërimet. Mua më vjen mirë që keni reflektuar dhe po shqetësoheni për karrierën diplomatike. Më lejoni t'ju them se edhe në emërimet e ambasadorëve, raporti që parasheh ligji është përmbysur. Nga 70% e ambasadorëve të emëruar nga jashtë karrierës diplomatike, nga të cilët dikush është liruar, dikush vazhdon të jetë në detyrë, vetëm për 30% i jeni përmbajtur ligjit. Pra, e keni shkelur ligjin me të dyja

këmbët. Më shqetësues është fakti se ju këtë përqindje e keni zbritur edhe në nivelet e tjera të hierarkisë diplomatike. Pra, nëse mund të jetë deri diku ndonjë rast i justifikuar për emërimet si ambasadorë, është totalisht e papranueshme dhe shkelje flagrante e ligjit që në nivelet e tjera të diplomacisë të bëhen emërtesa politike.

Për sa i përket strukturës së re, ajo duhet kohë të vijë, ministri na e ka premtuar një gjë të tillë dhe po punon për të. Të njëjtën gjë na e shpjegoi edhe sekretari i Përgjithshëm në mbledhjen e kaluar. Ne jemi të gatshëm të japim ndihmën tonë për reformën në diplomaci, por që ajo të bëhet e pjekur dhe të vlerësohen kapacitetet në diplomaci, pa dyshim që kjo kërkon kohë. Ne jemi në pritje të projektit për reformën, sigurisht duam të japim ndihmë tonë, por Ministria e Jashtme nuk ka ndonjë detyrim ta përfshijë komisionin. Ne kemi për detyrë ta monitorojmë këtë reformë, jemi duke e bërë, dhe nuk kemi pse seancat dëgjimore për ambasadorë t'i shndërrojmë në debate politike në lidhje me qëndrimet përkatëse që kanë maxhoranca dhe opozita për diplomacinë. Ne nuk kemi pse të ndahemi në këtë drejtim, të gjithë duhet të kërkojmë zbatimin e ligjit. Nëse keni elemente ku është shkelur ligji, jeni të lutur të mos i parashtrooni në mbledhje, por të ushtrooni të gjitha kompetencat që ju njeh ligji si deputetë dhe si anëtarë të këtij Komisioni për të kërkuar zbatimin e tij. Ne nuk kemi vënë re shkelje të ligjit.

Zoti Islami, meqë sugjeruat të bëjmë pyetje, deputetët janë të lutur t'i bëjnë. Më pas diskutimin do ta zhvillojmë në një seancë pa medie, në mënyrë që edhe ne të kemi një produkt efikas nga mbledhjet që po bëjmë, sepse nuk janë për *show* dhe medien, por për të gjykuar në dobi të interesave të konsolidimit të diplomacisë dhe në zbatim të ligjit për shërbimin e jashtëm.

Zoti Islami, urdhëroni!

Kastriot Islami – Faleminderit!

Në radhë të parë përshëndes të tre kandidatët për prezantimin!

Unë kam pyetje për dy nga kandidatët, zotin Bushati dhe zotin Ndreca.

Zoti Bushati, nisur nga një shqetësim i kohëve të fundit për marrëveshjen e ujërave me Maqedoninë, a e keni marrë të gjithë informacionin që ekziston në Shqipëri duke bërë njëkohësisht edhe sugjerimin përkatës? Do të ishte mirë që këtë çështje ta ndiqnit me përkushtim të veçantë, meqenëse ka një ndjesi, të paktën nga shqiptarët midis dy anëve të kufirit. Domethënë, a e keni marrë dosjen e plotë, të paktën të dhënat që janë nga Shqipëria, për sa u përket marrëveshjeve si nga pikëpamja politike, ashtu edhe diplomatike e juridike?

Zoti Ndreca jeton prej 23 vjetësh jashtë Shqipërisë, por ka qenë shumë aktiv në medien e shkruar në Shqipëri dhe për këtë duhet përshëndetur. Ju natyrisht keni qëndrimet tuaja dhe vlerësimet që janë në kompromitet me ndërgjegjen tuaj. Por ju keni mbajtur qëndrim edhe ndaj një personi, i cili do të marrë vendimin për të firmosur dekretin e emërimit tuaj si ambasador. A u qëndroni të gjitha vlerësimeve që keni për Presidentin e Republikës, apo në këtë moment keni një vlerësim tjetër?

Arta Dade – Faleminderit, zoti Islami!

Kush ka pyetje të tjera? Nuk ka.

(Diskutime pa mikrofon.)

Kastriot Islami – Unë thashë që diskutimin tonë ta bëjmë pa prezencën e ambasadorëve.

Arta Dade – Zoti Islami, më vjen keq, por kolegët e nderuar të opozitës, kur kemi pasur seanca të mbyllura, kanë shkelur rregulloren e këtij Komisioni dhe ia kanë dhënë procesverbalin medias.

Këtu nuk po bëhet fjalë për shqetësimin e medias, por Komisioni i Jashtëm, për vetë natyrën e punës që ka, mund të ketë edhe ndonjë pyetje për ambasadorët që mund të konsumohet pa praninë e saj.

Kush është dakord që të qëndrojnë media?

Aldo Bumçi – Ne kemi ranë dakord që në seanca të caktuara, nëse diskutohen tema që janë të nxehta, të zhvillohen pa medie. Në këtë rast është një seancë dëgjimore e hapur.

Arta Dade – Seanca dëgjimore mbaroi, ndërsa tani do të flasim.

Kalojmë në përgjigjen e pyetjeve.

Zoti Bushati, keni fjalën.

Petrit Bushati – Zonja kryetare, shumë faleminderit!

Zoti Islami, ju falënderoj për pyetjen!

Problemi i negocimit të ujërave me Republikën fqinje të Maqedonisë përbën përparësi për trajtimin e çështjeve dypalëshe, për shkak të një konflikti tokësor relativisht të gjatë. Desha të informoj komisionin e nderuar se në Maqedoni është ngritur dhe funksionon sekretariati i përbashkët me qendër në Ohër i Komunitetit të Menaxhimit të Pellgut të Ujëmbledhësit të Liqenit të Ohrit dhe të Prespës, i cili shqyrton politikën që zhvillohen në këtë rajon. Përveç kësaj, në mars të vitit 2003 palës maqedonase i është paraqitur projekt marrëveshja për problemet ujore.

Kjo çështje është ngritur vazhdimisht nga pala shqiptare në të gjitha takimet. Prezentë në komision janë edhe ministrat e jashtëm...

Kastriot Islami – Nuk ju kërkoja informacion. A jeni i pajisur me të gjitha dokumentet për...

Përparim Spahiu – U fol për një marrëveshje për ekonominë e ujërave...

Arta Dade – Zoti Islami, në prezantimin që bëri zoti Bushati e trajtoi këtë çështje.

Kastriot Islami – E di, por pyeta nëse e ka marrë bazën ligjore...

Përparim Spahiu – Zoti Islami, është shumë herët t'ia kërkojmë.

Ai është i qartë në atë që propozoi.

(Diskutime pa mikrofon.)

Petrit Bushati – Shumë prej jush e njohin të Drejtën Ndërkombëtare, sepse keni punuar dhe keni drejtuar diplomacitë. Çështja e ujërave me Maqedoninë është e tillë që për çdo problem që mund të dalë, duhet të zgjidhet vetëm në bazë të së Drejtës Ndërkombëtare, e cila përcakton regjimin e ujërave të vendeve kufitare edhe në bazë të marrëveshjeve dypalëshe. Gjatë ekspozesë sime përmenda edhe një marrëveshje të kohës së ish-Jugosllavisë; ka pasur komisione të përbashkëta, por shumë të tjera janë edhe të kësaj kohe. Ne jemi gjithmonë në avantazh në përpjekjen për të nënshkruar një marrëveshje me kuadër të plotë për regjimin e ujërave. Deri tani nuk ka asnjë devijim që vjen si obligim ndërkombëtar ose devijim nga politikat e sovranitetit dhe e shfrytëzimit të pasurive ujore dhe të tjera të Shqipërisë në marrëdhëniet pozitive që kemi me Maqedoninë. Përpjekjet do të vazhdojnë për të arritur një zgjidhje në mënyrën që përmenda më sipër.

Para disa vitesh ka pasur raste, jo vetëm në vitin 2005. Në qoftë se ju kujtohet një rast thatësire shumë e madhe kur prurjet e Drinit, që rrjedh nga liqeni Ohrit, u pakësuan. Në një marrëveshje dypalëshe u arrit që të lëshohet pak më tepër ujë për Drinin për mbushjen e pellgut të Fierzës. Natyrisht që kjo bëhet në bazë të rrethanave, por te marrëveshjet bazë, të cilat janë shumë serioze, do të mbrojmë në çdo paragraf interesat dhe sovranitetin e Shqipërisë, pa prishur as interesat e fqinjit maqedonas, sepse bashkëpunimi kërkon që marrëdhëniet të jenë të shkëlqyera. Nuk dua të përmend marrëveshje të shumanshme të shteteve të tjera lidhur me ujërat. Ne kemi një lumë shumë të madh në Ballkan, që është Danubi. Në Xherdap është ndërtuar një hidrocentral gjigant, që është më i madhi. Atëherë është bërë një marrëveshje midis Jugosllavisë, Serbisë sot, dhe Rumanisë, sepse u shërbente të dyjave. Në të ardhmen do të shikohet çdo

marrëveshje që na sjell përfitime dhe nuk cenon aspak interesat ekonomike, politike dhe sovranitetin e Shqipërisë.

Faleminderit!

Arta Dade – Faleminderit, zoti Bushati!

Fjalën e ka zoti Ndreca.

Ardian Ndreca – Do ta nis përgjigjen me pyetjen e zotit Islami, e cila ka të bëjë me qëndrimet e një qytetari privat, sepse në kohën kur kam botuar atë artikull kam qenë qytetar privat. Jo vetëm kaq, duke pasur parasysh se nga pikëpamja politike kam një parim liberal dhe të tillë e ndiej veten, mendoj se rastet për të shkruar në mënyrë kritike ndaj... (nuk mund të them ndaj palës suaj politike, sepse për një periudhë keni qenë edhe në krahun tjetër) kanë qenë aq të shumta dhe fatkëqija dhe roli i intelektualit në shoqëri duhet të jetë kritik. Shkolla e Frankfurtit dhe i gjithë shekulli XX na tregojnë që të vetmin rol që duhet të luajë intelektualit në shoqëri duhet të jetë ai kritik. Intelektuali nuk është në shoqëri për të lavdëruar palën politike, sidomos atë që është në pushtet, por duhet bërë kritika të shëndosha edhe për të mirën e punës. Jam përpjekur me koherencë morale. Po me atë vrull kam kritikuar qeverinë socialiste të Fatos Nanos, pa falur asnjë episod që në ndërgjegje më është dukur i drejtë dhe kam folur mirë për palën ku ju bëni pjesë tani. Jam përpjekur me ndërgjegje dhe kam vënë theksin në ato pika që më janë dukur kundër interesave të popullit dhe të kombit tim, përtej ndarjeve politike. Jam një person i paangazhuar nga ana partiake.

Kastriot Islami – Po ju pyes për Presidentin, jo për qëndrimet tuaja, sepse nuk kam asnjë gjë për to.

Ardian Ndreca – Po përpiqem t’ju përgjigjem në mënyrë sa më të plotë për të inkadruar edhe atë që ju e quani ose problematizimi si qëndrimin tim ndaj Presidentit të Republikës.

Kastriot Islami – Keni pasur një vlerësim...

Ardian Ndreca – Unë besoj te shteti republikan dhe te vlerat e institucioneve republikane.

Kastriot Islami – Ju bëra vetëm pyetje. Nuk bëra as koment, as vlerësim, madje nuk thashë gjë për qëndrimet tuaja.

Ardian Ndreca – Mua më është dukur një kakofoni që Presidenti i Republikës të merrte si këshilltar të tij një përfaqësues të monarkisë. Kam thënë që Republika këshillohet nga

Monarkia, por mendoni nëse do të ndodhte një gjë e tillë në Francën republikane! Vetëm këtë. Unë di ta dalloj vlerën e Presidentit të Republikës, si përfaqësues i institucioneve shtetërore të Shqipërisë, dhe di të dalloj Presidentin e Republikës si person me qëndrime politike. Kam respekt për institucionet republikane, ashtu siç kam respekt për flamurin e Shqipërisë, edhe nëse është i vjetër, që i ka dalë boja, apo i ri, i sapo ka dalë nga fabrika, po atë respekt kam edhe për përfaqësuesin, kushdo që të jetë, në krye të institucionit republikan, sepse besoj thellësisht te ky institucion.

Në rastin konkret, për Presidentin e Republikës së Shqipërisë kam respekt, sepse e ndihej veten si pjesëtar të kësaj republike. Ne kemi mbërritur sot këtu nëpërmjet sakrificave shumë të mëdha dhe Republika është një e mirë e madhe e të gjithë shqiptarëve, demokratë, liberalë apo socialistë.

Kastriot Islami – Unë e vlerësoj qëndrimin tuaj kritik. Nuk kam absolutisht asnjë gjë në parim ndaj saj. Ju keni mbajtur qëndrime dhe keni bërë cilësime për Presidentin, por unë ju pyeta nëse u qëndroni atyre.

Ardian Ndreca – Shpresoj që të jem mirëkuptuar prej të gjithë atyre që më ndjekin. Për Presidentin e Republikës, për institucionin e Presidencës së Republikës kam respekt të jashtëzakonshëm. Këtë gjë e kam treguar kur kam mbrojtur Presidentin Topi, i cili ishte zgjedhur prej së njëjtës forcë politike, kur është sulmuar, sipas meje, padrejtësisht në një kohë që nuk bëhej fjalë që unë të bëhesha ambasador apo të hyja në ndonjë organizëm. Kam mbrojtur institucionin e Presidencës me Presidentin Topi dhe jam po i atij mendimi edhe për institucionin e Presidencës në ditët e sotme, kushdo që ta kryesojë

Arta Dade – Zoti Ndreca, ju falënderoj për përgjigjen! Në fakt, parimi që ju shprehët këtu qëndron. Madje Presidenti duhet ta ketë caktuar, sepse ka qenë këshilltar në Ministrinë e Jashtme dhe ka pasur edhe një notë dërguar ambasadave të pranishme këtu, që të gjithë ambasadorët t'i adresoheshin këtij zotërisë këshilltar si: “Naltmadhëria Juaj”. Kjo është absurde në një republikë si jona.

Unë kisha një pyetje për ju, zoti Ndreca. Ju thatë në prezantimin tuaj se mund të kontribuoni që Shqipëria të avancojë fuqishëm në axhendën europiane dhe konstatuat se ne nuk jemi një shtet islamik dhe folët edhe për gjuhën latine në dokumentet në vazhdim në kohën e Mesjetës dhe më vonë. A mendoni se ka pasur ndonjë tentativë për ta përkufizuar Shqipërinë si një vend islamik dhe kjo të ketë krijuar një problem në avancimin e axhendës sonë europiane, sepse unë

personalisht nuk e mendoj këtë gjë? Por ndoshta ju patët një arsye që e veçuat këtë shqetësim, që do të përbënte edhe një nga drejtimit e punës suaj në rolin që mund të luajë Selia e Shenjtë për integrimin e Shqipërisë në BE.

Ardian Ndreca – Së pari, dua të them se islami shqiptar është një islam *sui generis* në të gjithë rajonin, sepse është një islam tolerant. Së dyti, iu referova, edhe pse nuk i citova në mënyrë të drejtpërdrejtë, disa shënimeve pretekstuale të një pjese të disa partive ekstremisht të djathta, siç ishin disa grupime politike holandeze, të cila në mënyrë pretekstuale e paraqitë këtë si një vështirësi reale për integrimin tonë në Europë.

Jam i bindur se islami shqiptar është një vlerë për ne dhe ka shumë për t’i mësuar botës, ashtu siç ka shumë për t’i mësuar botës edhe trashëgimia kulturore kristiane shqiptare (ortodokse dhe katolike së bashku), që kanë mbijetuar në kushtet të një shtypjeje disashekullore të pamëshirshme.

(Ka pyetje dhe diskutime që nuk dëgjohen.)

Kastriot Islami – Duke vlerësuar prezantimin dhe CV-në, kam parë maksimalisht propozimin për zotin Bushati. Është një diplomat karriere, me një eksperiencë të gjatë. Është nga figurat që e meriton gradën ambasador. Kjo i bën mirë jo vetëm zotit Bushati, por gjithë sistemit të karrierës dhe gjithë Shqipërisë, ku në një vend siç ka qenë më parë unioni Serbi-Mal i Zi, Amerika apo Maqedonia, ne të kishim një ambasador të tillë. Ky është një koment dhe një mesazh për ministrin e Jashtëm. Ka edhe figura të tjera që e meritojnë gradën ambasador, por e kam në mënyrë konkrete për zotin Bushati.

E dyta, për zotin Minxhozi do të vlerësoja emërimin. Fatkeqësisht, i ka dalë parashikimi im. Kur ai ka qenë ambasador, unë kam qenë në një post që e kam lutur për të ardhur e për t’u bërë deputet, për shkak të cilësive të tij, dhe tani për shkak po sërish të cilësive të tij rikthehet ambasador. I uroj punë të mbarë.

E treta, lidhur me zotin Ndreca, mendoj se nuk është aq *implicite* dhe duke vlerësuar qëndrimin e tij kritik ndaj politikës e personazheve të ndryshme etj., do të kisha preferuar guximin për të thënë ato që ai ka pasur si cilësime dhe vlerësime për Presidentin. Nuk është puna se është ai rast, i cili mundet që në vlerësimin e kandidati për ambasador..... është një vlerësim jo i kritikueshëm në gjykimin tim. Ai e ka quajtur Presidentin “figurë groteske”, “ulok moral”, në një artikull tjetër “të lig”. Pra, janë ca cilësime që kalojnë përtej etikës ndaj figurës së

Presidentit. Mua më duket se është në një konflikt interesi moral me Presidentin e Republikës, për vetë cilësimet që ka bërë.

Faleminderit!

Arta Dade – Unë jam e bindur se Presidenti do të dijë ta ndajë veten nga individit Bujar Nishani dhe nga institucioni i Presidentit. Ju tani i bëtë një shërbim shumë të mirë kandidaturës së zotit Ndreca, sepse jam e bindur se Presidenti do të ndikohej nga komenti juaj dhe do ta dekretojë.

Kastriot Islami – Unë nuk e di, po të ishit ju dhe t’ju quanin “uloke morale”, a do të kishit forcë për të firmosur?

Arta Dade – Ne nuk jemi këtu për të bërë avokatinë e Presidentit.

Zoti Dokle, urdhëroni!

Namik Dokle – Unë dua të vlerësoj, së pari, zotin Bushati si një diplomat karriere dhe me karrierë diplomatike të pastër. Në çdo rast, edhe në shtete të vështira, edhe në shtete më pak të vështira, zoti Bushati ka treguar integritet si diplomat dhe si përfaqësues i shtetit shqiptar.

Dua të them fjalët më të mira për zotin Minxhozi, sepse ne e njohim dhe duhet të flasim më pak, sepse ka qenë për shumë vjet anëtar i këtij komisioni, por karriera diplomatike që ka pasur e ka ndihmuar të kryejë më mirë detyrën e deputetit dhe besoj se karriera e deputetit dhe anëtarit të Komisionit të Jashtëm do ta ndihmojë të kryejë edhe detyrën e diplomatit. Për më tepër, që diplomati është një diplomat i stilit të veçantë.

(Nuk dëgjohet)

Sa i përket zotit Ndreca, do të doja të bëja një vlerësim maksimal si një intelektual i formuar. Zoti Bumçi në përpjekjen e tij për të thënë ka rënë ose s’ka rënë reforma, midis të tjerave tha një të vërtetë dhe një gjë që ne e ndiejmë si nevojë për shërbimin tonë diplomatik: që diplomati duhet ta njohë mirë vendin ku shkon për të kryer detyrën shtetërore. Pra, të jetë në ujërat e tij, sepse ndryshe do të mbetet si peshku në zall dhe nuk do të bëjë dot gjë jo vetëm për shtetin, por as për veten. Unë mendoj se zoti Ndreca, si njohës dhe i njohur në Selinë e Shenjtë, do të kontribuojë shumë pozitivisht për të përfaqësuar kulturën shqiptare, tolerancën fetare shqiptare, si dhe vlerat që ka Shqipëria jo vetëm sot, por edhe në të kaluarën, vlera që janë shumë të mirëpritura në Selinë e Shenjtë. Më pëlqen ideja e zotit Ndreca lidhur me çfarë mund të kontribuohet për pasurimin e historisë së Shqipërisë nëpërmjet dokumenteve të Selisë së Shenjtë. Historia e Shqipërisë është cunuar shpesh nga mungesa e dokumenteve, sepse dihet se shumë

nga dokumentet që kanë qenë vlera për historinë e Shqipërisë janë vjedhur, janë djegur etj, etj. Armiqtë e shqiptarëve e të Shqipërisë kanë arritur të vjedhin edhe kafkat nëpër varret e shqiptarëve, për të vërtetuar se nuk janë ata që janë. Deri aty kanë arritur dhe ky është një fakt historik. Prandaj, puna e një ambasadori në vendin ku shkon është të bëjë maksimumin për vendin e vet nëpërmjet njohjes së të gjitha resurseve që ka vendi ku ai përfaqëson shtetin e tij. Nga kjo pikëpamje unë mendoj se është një nga kandidaturat më të gjetura për të përfaqësuar shtetin shqiptar në Vatikan, duke e krahasuar historikisht me kandidaturat e tjera që kemi patur në Vatikan, përjashtuar zotin Pepa, i cili edhe ai ka qenë një njohës shumë i mirë.

Ben Blushi – Edhe unë dua të vlerësoj të tre kandidatët, pa dyshim shërbimi pasurohet me eksperiencat e tyre për të gjithë në shërbimi ka më shumë dinjitet dhe cilësi me kandidaturat tuaja të këtij niveli.

Pa dyshim kam vlerësim të lartë për zotin Ndreca, pavarësisht se nuk e njoh nga afër veprimtarinë e tij akademike apo universitare. Mjafton CV-ja që të jem shumë i nderuar që kam mundësi të votoj pozitivisht për zotin Ndreca si ambasador në Vatikan. Por zoti Ndreca hapi sot një çështje në parim. Ne kemi pasur një debat në seancën e kaluar të këtij komisioni për parimet mbi të cilat ndërtohet shërbimi diplomatik.

Zoti Ndreca foli për republikanizmin si një parim i sanksionuar në Kushtetutën e Shqipërisë, ne jemi republikë parlamentare. Por sigurisht që Kushtetuta ka disa parime të tjera, ne kemi folur herën e kaluar për laicitetin e shtetit, ju folët sot për flamurin. Kushtetuta ka sanksionuar që bashkë me flamurin shteti shqiptar ka disa simbole të tjera dhe një nga këto është gjuha letrare. Ju shoh nga ajo që keni përcaktuar në CV-në tuaj që ju e konsumoni aktivitetin tuaj akademike në gegnisht apo jo, nëse nuk jam gabim.

Anton Ndreca – Në përgjithësi po

Ben Blushi – Unë citoj disa prej shkrimeve tuaja “Shija e harrueme e të qenurit njeri”, “Shteti laik dhe anmiqtë e tij”, ne themi “armiqtë” ju thoni “anmiqtë”. Unë shkruaj vetë, zoti Ndreca. Sigurisht, ju jeni person i pavarur, mendimtar i lirë. Mund të shkruash në të gjitha dialektet e shqipes, mund të shkruash në gegnisht, italisht, anglisht, por për jetën zyrtare të këtij shteti ka disa parime, që gjuha, flamuri janë simbole kombëtare të pacenueshme. Gjuha letrare është ndoshta një nga arsyt pse jemi bashkë sot këtu. Ndoshta në kushte të tjera, ju e dini më mirë se unë, pa gjuhën shqipe Shqipëria nuk do të ishte. Kemi më se dyzet vjet që kemi

përcaktuar normën letrare kombëtare. Ka pikëpamje të ndryshme nëse gjuha letrare është normë e përshtatshme për ne apo jo. Këtë normë gjuhësore është e pamundur ta kthejmë mbrapsht.

Sigurisht, mendimi im nuk është përfundimtar. Ka njerëz që e pranojnë se gjuha letrare duhet pasuruar me gegërishten. Unë nuk kam asnjë paragjykim për gegnishten, përkundrazi. Më shijon Gjergj Fishta, Koliqi, Migjeni. Paraardhësit e mi kanë shkruar gegërisht, para gjuhës letrare. Pra, e pëlqej si variant letrar, por jo si normë zyrtare. Pa dashur t'ju bëj asnjë kritikë, po ju them vetëm një gjë: ju do të komunikoni me shtetin shqiptar në gegërisht? Kjo është çështja pra ku fillon e ku mbaron kufiri i parimeve: cenimi i laicitetit, cenimi i gjuhës letrare, cenimi i simboleve kombëtare. Besoj se me akademikë të sërës suaj ky debat ia vlen të bëhet, sepse është një debat themelor jo vetëm për zyrtarët shqiptarë, po për inteligjencien shqiptare në përgjithësi. Ka shumë kakofoni për gjuhën, për raportin e shtetit me fenë, për simbolet kombëtare. Edhe me që mu dha rasti dhe e hapëm këtë debat shpresoj që jo si radhën e kaluar, nuk do të paragjykojem si njeri që jam kundër gegnishtes. Por le të paragjykojem si njeri i cili beson se gjuha letrare, laiciteti i shtetit janë thelbi i Kushtetutës dhe i kombit tonë. Besoj më kuptuat.

Ardian Ndreca – Të gjitha shkrimet që ju cituat janë shkrime jozyrtare, janë shkrime letrare ose ese. Për sa kohë që standardi i vitit 1972 do të jetë gjuha zyrtare e Republikës së Shqipërisë, unë në komunikimet e mia zyrtare do të përdor këtë standard, ashtu siç e kam përdorur deri tashti. Madje e përdor pa gabime, me shumë më pak gabime se letrat zyrtare që kam marrë ndonjëherë prej administratës shtetërore.

Valentina Leskaj – Besoj që komisionit i vjen mirë kur diskutojmë për kandidatura si sot, për atë që ata i ofrojnë dhe mund t'i ofrojnë diplomacisë shqiptare. Dua ta filloj nga Z. Bushati që sic e thanë dhe kolegët e mi është një diplomat me një karrierë të gjatë. Kam pasur rastin të njoh Z. Bushati, madje pa hyrë në politikë, kur ai ka qenë ambasador në SHBA, në Uashington, Kongresin Amerikan, Shtëpinë e Bardhë, ka bërë një përfaqësim dinjitoz dhe unë besoj që të gjithë ndjehemi mirë kur ka ambasadorë të këtij kualiteti.

Dua të them për zotin Minxhozi, i cili ka qenë ambasador pa qenë ambasador i akredituar në Danimarkë, e ka bërë këtë punë për vendin e tij, edhe pse nuk e ka pasur një detyrë zyrtare. Jam e sigurt që duke qenë një ambasador tashmë në Kosovë, e cila ka specifikat e veta, natyrisht që do të bëjë një punë të përkryer. Unë do të thoja që puna e ambasadorit ndonjëherë bëhet jo vetëm me vepra, por edhe me emrin, i cili është shumë i rëndësishëm. Ky është edhe rasti i zotit Ndreca, të cilin besoj të gjithë e njohim, mbase jo fizikisht, por nga aktiviteti i tij, nga shkrimet,

pjesëmarrja ne debate. Natyrisht unë kisha të njëjtin shqetësim me zotin Blushi për sa i përket çështjes së gjuhës duke e parë CV-në edhe duke parë edhe aktivitetin, duke ndjekur edhe ato që juve keni shkruar e di që keni qenë dhe pjesë e debatit prej vitesh për sa i përket çështjes së normës zyrtare të gjuhës shqipe. Ka njerëz që preferojnë gegërishten dhe ka njerëz që preferojnë normën letrare, por në fund të fundit, zyrtarisht ne kemi një gjuhë e cila është gjuha aktuale që përdoret për t'u zbatuar. Përgjigjja e zotit Ndreca e zgjidhi dhe këtë dilemë që ne kishim në komision.

Çështja tjetër që doja të prekja ka të bëjë me atë problemin që ngriti zoti Bumçi, i cili tha se reforma ka rënë sepse nga 11 kandidatë që kanë ardhur 6 janë nga jashtë sistemit. Ne në radhë të parë nuk na lejohet që si Komision i Jashtëm që çështjen e reformave ta shohim si çështje numrash qoftë që ka të bëjë me raportin politikë-jo politikë. Unë besoj që koncepti i reformës në diplomaci dhe reforma në diplomaci është shumë më i gjerë se sa kaq, po natyrisht ne duhet të ishim kritikë dhe do ishim të parët, siç kemi qenë dhe më parë kritikë, kur në kohën tuaj janë shkelur raportet që përcakton ligji. Natyrisht ne nuk ka nevojë të bëjmë ndonjë shkencë për këtë se është e përcaktuar në ligj që vetëm 20% mund të vijnë nga politika. Kjo është arsyeja që i kemi kërkuar edhe ministrit të Jashtëm të na sjellë një program kuadër, dhe kemi vendosur dhe këtu në komision që të na sjellë një program në mënyrë që të kemi mundësinë të gjykojmë në tërësi, dhe jo rast pas rasti, sepse ne sot po i gjykojmë rast pas rasti. Në fakt, kandidatët që janë sot, nuk janë kandidat që vijnë nga politika dhe ky debat nuk është se i vlen kësaj seance dëgjimore, por ajo që do të them është se reforma në diplomaci nuk është çështje numrash, nuk është çështje raportesh politikë-jo politikë që natyrisht ka një rëndësi, por shkon përtej kësaj. Unë besoj që duhet propozuar që në komision që ne të kemi një diskutim për sa i përket reformës në diplomaci, e pse jo të jetë dhe ministri këtu për të dhënë shpjegimet e veta dhe që ne të kemi një informacion, edhe atë që kemi kërkuar pra për një program kuadër përkatës. Faleminderit!

Arta Dade – Faleminderit, zonja Leskaj!

Atëherë, të nderuar kolegë, zoti sekretar i Përgjithshëm, zoti Minxhozi, zoti Bushati, zoti Ndreca, për të konkluduar më lejoni të vlerësoj kandidaturat për ambasadorë të Republikës së Shqipërisë pranë Selisë së Shenjtë, Republikës së Kosovës, dhe Republikës së Maqedonisë. Ashtu sikurse e thatë edhe ju kemi të bëjmë me një kandidaturë të spikatur si zotin Bushati, madje e mbështes zotin Islami në propozimin që Ministria e Jashtme duhet të bëjë kujdes edhe

për të dhënë gradat që meritojnë diplomatëve të nderuar, aq më tepër ata që kanë përvojë e kanë shtuar vlerën në shërbimin tonë diplomatik.

Zoti Bushati shkon në një vend të rëndësishëm edhe me problematika që dalin herë pas here. Jam e bindur që do të ketë durimin që e karakterizon, njohjen e thellë që ka si diplomat dhe njohjen që ka për rajonin. Ky do të jetë një element shtesë në zgjidhjen edhe të një sërë çështjesh që herë pas here duket se janë të vështira për t'u zgjidhur.

Lidhur me zotin Minxhozi unë kam një sentiment të veçantë sepse e njoh që kur kemi qenë 15 vjeç; i njoh edhe kapacitet e tij menaxhuese, vullnetin e tij të spikatur për të realizuar atë çka duhet realizuar dhe kam kënaqësi të veçantë që do ta kemi ambasador në Kosovë. Nuk e di a u shpreh këtu, por ne kemi një mangësi të madhe lidhur me marrëdhëniet dypalëshe me Kosovën. Gjithashtu, duhet të funksionojnë më mirë marrëdhëniet parlamentare në mënyrë të veçantë të dy Komisioneve të Jashtëm të të dy vendeve. Jam e bindur se do të krijojmë të gjitha hapësirat për bashkëpunimin edhe me komisionet e tjera në funksion të realizimit të asaj strategjie tashmë të shprehur në programin qeverisës dhe në hapat mjaft të spikatur që janë hedhur nga të dy qeveritë në mbledhjet e përbashkëta dhe me marrëveshjet që janë nënshkruar deri tani.

Sigurisht që dua të bëj një dy komente në lidhje me kandidaturën e zotit Ndreca. Personalisht e vlerësoj përgjigjen që ai dha. Vlerësoj faktin që kemi të bëjmë me një kandidaturë që nuk vjen nga politika.

Këtu u tha që 20% duhet të jenë kandidatura politike. Nuk është ashtu. Madje ligji e parashikon që 20% në emërimin e ambasadorëve të jetë jashtë sferës së diplomacisë. Kjo nuk presupozon që ata të jenë kandidatura politike, por të jenë kandidatura që vijnë nga bota akademike, kultura, nga shkenca, nga arti. Unë e vlerësoj kandidaturën e zotit Ndreca si një figurë e spikatur, që vjen nga fusha akademike që do të sillte në bashkëpunimin me Selinë e Shenjtë ato vlera që edhe kolegët i shprehën. Unë besoj fuqishëm që zoti President nuk do të ndikohet nga sensibilitete të shprehura dhe këtu në komision, por do të shikojë e vlerësojë kandidaturën në dobi të interesave të bashkëpunimit dypalësh të Shqipërisë me Selinë e Shenjtë, por gjithashtu me autoritetin dhe ndikimin që Selia e Shenjtë ka në të gjithë sferën marrëdhënieve diplomatike dypalëshe e shumë palëshe. Dhe kandidatura e zotit Ndreca do të rrisi vlerat për një bashkëpunim të tillë.

Duke përfunduar, ju falënderoj për diskutimet, madje vlerësoj dhe vërejtjet, sepse jam e bindur që ato burojnë nga dëshira dhe nga qëllimi që ne t'i japim vendit një shërbim diplomatik profesional, dinamik dhe në shërbim të interesave të vendit.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA